



BASHKIA MIRDITË

Rrëshen më 19.12.2025

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Përmirësim i infrastrukturës turistike “Shtegu Future Mind”, me platforma shikimi, stola, ura, rampa në fshatin Lufaj, Bashkia Mirditë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi sipas FPP- Punime ndërtimi, 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 29 975 134 (Njëzet e nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tridhjetë e katër) **Lekë pa TVSH,**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar),autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas Shtojcës 8 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2022, 2023, 2024**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.2.2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (**2022, 2023, 2024**) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës.(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 43, pika 2/b dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën oferten të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kollaudit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.
 - Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

- 1.1** Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.2** Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikava (a-b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: ***”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e***

teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.***

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave a dhe b, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos ne kushte te barabarta dhe u jep mundësi te gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund te jene te paplotesuara sipas standartit.

AK ka kerkuar keto dokumenta ne perputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: ***Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.***

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë:

2.3.2/1 Kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1/A	Punime gjurmimi në tokë
2	NP-2/A	Ndertime civile dhe industrial
3	NP-5/A	Punime nentokesore, ura dhe vepra arti
4	NP-11/A	Ndertime per nenstacionet,kabinat e transformatoreve,linjat e TN e te mesem dhe shperndarjen e nergjise.
5	NS-2	Impjante hidrosanitare,kuzhina lavanteri, mirembajtja e tyre.
6	NS-4	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri,plastik,metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese
7	NS-8	Ndertime parafabrikat beton arme,struktura metalike dhe druri.

8	NS-9	Punime strukturore special
9	NS-14	Impjante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
10	NS-18	Punime topogjeodezike

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

2.3.2/2 Personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Elektrik

1 (një) Inxhinier Gjeodet

****Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik, gjeodet, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paafhtësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim

me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **25 (njëzet e pesë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën **tre muaj nga data e hapjes se ofertave**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohe nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën e kërkuar.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohe nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohe që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistët e fushës kanë bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e*

kriterit për një punësim të paktën 25 punonjës, është në përputhje me volumnin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “ *Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*”. Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore)

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë punëtore që kërkohet për realizimin e punimeve është min **25 punonjës**.

2.3.4 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Strukturist)

1 (një) Arkitekt

1 (një) Inxhinier Gjeodet

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për disponimin e stafit mbështetës është e justifikuar nga natyra dhe kompleksiteti i punimeve objekt kontrate dhe synon garantimin e cilësisë teknike, saktësisë së zbatimit dhe respektimit të projektit gjatë të gjitha fazave të realizimit të punimeve. Prania e këtyre profileve profesionale siguron kontrollin e elementeve strukturorë, përputhshmërinë arkitektonike si dhe saktësinë e matjeve dhe

piketimeve në terren, duke minimizuar riskun teknik dhe duke garantuar përmbushjen e standardeve teknike dhe ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 *“Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”*”.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 *“Për Prokurimin Publik”* (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”*, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë..“.

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit e kerkuar, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të

shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” rekomandohet të jete ne kantier per minizimin e aksidenteve ne pune.

2.3.6 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** (*Inxhinier Ndërtimi*) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm në objekt për drejtimin teknik te punimeve dhe *nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

*“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: **Diplomë, librezë pune dhe kontratë pune.***

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “*drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi*” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “*drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “*Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit*” dhe pika 2: “*elementët e licensës*” gërma “c” ku citohet se: “*Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë.*

Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, si më poshtë:

Teknik i mesëm ndërtimi	1 (një)
Teknik i mesëm gjeodet/topograf	1 (një)
Karpentier	1 (një)
Specialist për punime betoni	1 (një)
Specialist për punime hekuri	1 (një)
Hidraulik	1 (një)
Eskavatorist	1 (një)
Automakinist	1 (një)
Shofer	2 (dy)
Saldator	1 (një)

Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontrata e punës, e vlefshme;
- Të figurojë në Listpagesat e subjektit për periudhën e kerkuar. (për mjetet e marra me qera stafi eskavatorist, automakinist, buldozerist, shofer mund të disponohen nga operatori ekonomik edhe nepermjet kontraktimit. Deklarata të plotësohet sipas kërkesës mëposhtme)
- Dokument (diplomë/certifikatë e arsimit profesional) që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm, lëshuar nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”. Për tekniket duhet të deklarohen dhe paraqitet diplome e shkolles së mesme teknike ndërsa Për punonjësit Eskavatorist/Automakinist/Shofer të paraqiten leje drejtimi, certifikate e aftësi profesionale / Patente Manovrimi nga DPSHTRR).

Për të gjithë stafin teknik, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë: emrin dhe mbiemrin; profesionin/profilin e punës; numrin e kontratës individuale të punës dhe afatit të vlefshmerisë së saj; numrin e diplomës/certifikatës së arsimit profesional/Patentës Manovrimi nga DPSHTRR dhe afatit të vlefshmerisë së saj si edhe autoritetin leshues të saj shoqëruar me niptin perkates kur keto autoritete janë private.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.Qëllimi i

vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga organe kompetente .

Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punes si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 7 t	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Kamionçinë vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Fadromë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Makineri ngjitje tuba PE	në pronësi ose me qira	Copë 1

5	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Eskavatorë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Damper/minidamper kantieri me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Vibratorë	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Autobetoniere e vogel	në pronësi ose me qira	Copë 1

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 8. *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:*

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet: dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit; leja e qarkullimit; çertifikata e kontrollit teknik; siguracioni; leja e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse; Ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për impiantin/fabrikën/nyjen e betonit duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore përkatëse, foto dhe lejen mjedisore kodi III.1.B lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë. Operatori ekonomik mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit përkatëse.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet ose pajisje të deklaruar ku, për automjetet e targuara, të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,

që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 *Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

- ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*
- ISO 14001:2015 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*
- ISO 45001: 2018 *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga

Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.4.2 *Grafiku i punimeve sipas zerave të preventivit dhe afatit të përcaktuar në njoftimin e kontratës.*

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë, sëbashku me preventivin, edhe analizat teknike për të gjitha zerat e preventivit të ofertes. Analizat të paraqiten sipas formës ligjore për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.

2.4.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).*

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Punimet objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, bazohen në parashikimet e nenit 4, nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 39 pika 2, të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të këtij objekti prokurimi janë marrë në dorëzim nga komisioni I marrjes në dorëzim, sipas materialit bashkëlidhur në SPE.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.566 datë 19.11.2025, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **“Përmirësim i infrastrukturës turistike “Shtegu Future Mind”, me platforma shikimi, stola, ura, rampa në**

fshatin Lufaj, Bashkia Mirditë, me fond limit prej: **29 975 134** (Njëzet e nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tridhjetë e katër) **Lekë pa TVSH, lloji i procedures: E hapur-Punë.**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kriteret teknike janë hartuar nga specialisti i fushës referuar pikës 4 të nenit 74 të Vkm-së nr.285, dt 19.05.2021, I ndryshuar

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP

NJESIA E PROKURIMIT